

VENDIM
Nr. 335, datë 22.5.2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 294, DATË 8.4.2015, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT TË
INVESTIMEVE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të marrëveshjes, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për bashkëpunimin në mbështetje të klimës së investimeve dhe qeverisjes së mirë, nënshkruar më 24 shkurt 2014, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 294, datë 8.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Pika 5 ndryshohet si më poshtë vijon:

"5. Këshilli i Investimeve kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe ka në përbërje të tij përfaqësues nga qeveria, sektori privat dhe partnerët për zhvillim, si më poshtë vijon:

a) anëtarë me status të përhershëm:

i. institucione shtetërore, 3 anëtarë:

- ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
- Banka e Shqipërisë;
- Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve;

ii. partnerë zhvillimi, 3 anëtarë:

- Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH);
- Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC)/Banka Botërore;
- Delegacioni i Bashkimit Evropian;

iii. Dhoma të Tregtisë dhe Industrisë, 2 anëtarë:

- Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë;
- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë.

b) Anëtarë me status të përkohshëm me mandat 2-vjeçar:

i. Shoqata biznesi, 4 anëtarë.

c) anëtarë *ad-hoc*:

Shoqëri tregtare, 2 anëtarë.

Pjesëmarrja e anëtarëve me status të përkohshëm dhe *ad-hoc* caktohet nga sekretariati.

Përzgjedhja e shoqatave të biznesit bëhet duke pasur në konsideratë kriteret e mëposhtme:

- Numrin e anëtarëve, vitin e themelimit të shoqatave të biznesit dhe transparencën publike në qeverisjen e shoqatës;

- Përfaqësimin e investitorëve vendas e të huaj dhe sektorët që përfaqëson secila shoqatë biznesi;

- Materialet e publikuara, indekset e biznesit të përgatitura dhe analizat ligjore e ekonomike për çështje të klimës së biznesit;

- Angazhimin dhe kapacitetet për të përmbushur funksionet si anëtar në Këshillin e Investimeve."

2. Pika 16 ndryshohet si më poshtë vijon:

"16. Numri i mbledhjeve të rregullta të Këshillit të Investimeve të jetë, të paktën, 4 (katër) mbledhje në vit."

3. Pika 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"18. Kostot e stafit, të mobilimit të zyrave e të komunikimit do të mbulohen nga BERZH-i dhe partnerët për zhvillim."

4. Kudo në vendim:

a) Fjalët “ministrit për Zhvillimin Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes” dhe “Ministria për Zhvillimin Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes” zëvendësohen, përkatësisht, me “ministrit përgjegjës për ekonominë” dhe “ministra përgjegjëse për ekonominë”;

b) Fjala “... donatorët ...” zëvendësohet me fjalët “... partnerët për zhvillim ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama